Në kuadër të programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP),Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) organizon sesionin e radhës të EVP.

Tema: Menaxhimi i bazuar në vlerë (ValueBased Management)

Data: 10 nëntor, 2026

Orari: 09:00 – 14:00 (pauza e drekës 12:00-13:00)

Ligjërues: Naim Avdiu– Kontabilist i Certifikuar

Regjistrohu për pjesëmarrje në EVP deri më 09/11/2026 në: https://portal.scaak.org/
përmes portalit ju mund të zgjedhni të merrni pjesë fizikisht apo online si dhe të gjeneroni profaturën

***regjistrimi në portal vlen vetëm për anëtarët aktiv të ShKÇAK**

***sesionet që janë 2 ditore nënkupton se përmbajnë tema të kombinuara dhe kanë vazhdimësi p.sh. dita 1 me ditën 2. Në momentin që konfirmoni sesion 2 ditorë obligoheni që të merrni pjesë në 2 ditët e EVP-së.**

Ndërsa anëtarët jo aktiv dhe të interesuarit e jashtëm për pjesëmarrje në EVP mund të na kontaktojnë përmes: anëtarët@scaak.org

Ky seminar do t'iu sigurojë katër (4) orë të verifikueshme të EVP-së, që rezulton në pagesë totale prej EUR 80.00, ndërsa për anëtarët aktiv për vitin 2026 EUR 40.00.

Pagesat duhet që të kryhen në njërën nga Llogaritë bankare si në vijim:

Banka: ProCredit Bank
Xhrll. Nr. 1110161271000192

Banka Për Biznes
Xhrll. Nr. 1300271200089555

Përshkrimi-Për: ShKAK SCAAK

*****Konfirmimi për pjesëmarrje dhe pagesa është e obligueshme ndërsa për vendin e saktë do t'iu informojmë pas pranimit të konfirmimeve.

****** Kjo temë e EVP është në kuadër të temave të obligueshme.

******* Edukimi i Vazhdueshëm Profesional është i obligueshëm për anëtarët e ShKÇAK, për thirrjet si në vijim:

Auditorët ligjor – obligohen që të kenë 40 orë të EVP brenda vitit kalendarik, prej të cilave së paku 24 orë të verifikueshme. Nga orët e veritifikueshme 12 orë duhet të jenë nga temat e obligueshme.

Auditorët e Çertifikuar dhe Kontabilistët e Çertifikuar – obligohen që të kenë 20 orë të EVP brenda vitit kalendarik, prej të cilave së paku 12 orë të verifikueshme. Nga orët e verifikueshme 6 orë duhet të jenë nga temat e obligueshme. *Auditorët e Çertifikuar që synojnë të aplikojnë për licencë "Auditor Ligjor" duhet të kenë parasysh se sipas UA Nr. 01/2019 kërkohen nga* ***24 orë të verifikueshme në 3 vitet e fundit****.*

Auditorët e Brendshëm të Çertifikuar – obligohen që të kenë 30 orë të EVP brenda vitit kalendarik, prej të cilave së paku 12 orë të verifikueshme. Nga orët e verifikueshme 6 orë duhet të jenë nga temat e obligueshme.

Planin vjetor të EVP për vitin 2026 mund t'a shkarkoni duke klikuar KËTU